

VENDIM
Nr.1. datë 25.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Kristaq Ngjela	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Evjeni Sinojmeri	Anëtare
Agron Lamaj	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Irma Bala	Anëtare
Shpresa Beçaj	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 25.1.2007 morën në shqyrtim çështjen penale me nr.2/2, me:

KËRKUES: PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIMET E RËNDA TIRANË, përfaqësuar nga prokurori Artur Selmani.

KUNDËR: PERSONIT NËN HETIM XHEVDET TROPLINI, përfaqësuar nga avokati Skënder Demiraj.

PERSONA TË TRETË: SHEFQET TROPLINI, LULE TROPLINI, MAJLINDA TROPLINI, të përfaqësuar nga avokati Skënder Demiraj.

OBJEKTI: Sekuestrim i pasurive: objektet e ish-Ndërmarrjes së Rritjes dhe Zënies së Peshkut Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 9.900 m², vlerat monetare prej 23.726.600 lekë, 20.505 euro dhe 203 dollarë amerikanë.

Baza ligjore: Nenet 7 dhe 13 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.39, datë 12.6.2006, ka vendosur:

Vendosjen e masës së sekuestros mbi pasuritë e personit nën hetim Xhevdet Troplini, si më poshtë:

Pasuria e paluajtshme, ndodhur në zonën kadastrale nr.8517, me nr.147/1 pasurie, me adresë në Spitallë Durrës, ish-“Ndërmarrja e Rritjes dhe Zënies së Peshkut” Durrës, me objektet që ndodhen në të, me sipërfaqe totale 9900 m², nga të cilat 1850 m² janë nën objekt dhe 8050 m² truall i lirë, me kufizime: Veri-pasuria nr.147/12, lindje-pasuria nr.217, jug-pasuria nr.238/1, perëndim- pasuria nr.147/12.

Sasia në vlerë monetare prej 23.726.600 (njëzet e tre milion e shtatëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekë, 20.505 (njëzet mijë e pesë qind e pesë) euro, 203 (dyqind e tre) dollarë amerikanë.

Për administrimin dhe përdorimin e kësaj pasurie caktohet agjencia për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara pranë Ministrisë së Financave, Tiranë.

Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.37, datë 10.7.2006, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.39, datë 12.6.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs personi nën hetim Xhevdet Troplini, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe duke e gjykuar çështjen në fakt të vendoset rrëzimi i kërkesës së prokurorit për sekuestrimin e pasurisë, duke parashtuar këto shkaqe:

Shkelje të ligjit procedural:

- Ligji ku mbështetet prokurori dhe dy gjykatat është ligji nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar". Prokurori duhej t'i referohej nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se objekti mbi 10 milion lekë gjykohet nga tre gjyqtarë. Prandaj, përbërja e gjykatës për gjykimin e kësaj çështjeje është në kundërshtim me ligjin, pasi ligji nr.9284, datë 30.9.2004 nuk të referon te Kodi i Procedurës Penale, por te Kodi i Procedurës Civile. Çështja duhet të gjykohej me 5 gjyqtarë.

Shkelje të ligjit material:

- Gjykatës iu paraqitën të gjitha dokumentet zyrtare se familja Troplini është një familje bujqësore që nga viti 1992. Ne i kërkuam gjykatës së shkallës së parë dhe prokurorit që të bënte verifikimin në vend të kësaj pasurie. Organet e pushtetit vendor mbi kërkesën tonë verifikuan në vend pasurinë e kësaj familjeje ku rezultoi ekzistenca e familjes bujqësore.

- Meqenëse e gjithë pasuria e familjes Troplini është pronë e familjes bujqësore sipas nenit 207 e 222 vijues të Kodit Civil, nuk është i mbështetur në ligj dhe prova përfundimi i gjykatës se mjetet monetare të gjetura në banesë janë të Xhevdet Troplinit. Në atë banesë banojnë edhe Shefqeti, Lulja, Majlinda dhe 2 fëmijët e tij.

- Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në mbrojtje të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, mundohet të interpretojë nenin 13 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, duke arsyetuar se prokurori mund t'i kërkojë gjykatës të sekuestrojë çdo pasuri të personave që kanë lidhje gjaku e krushqie me personin nën hetim, pavarësisht se pasuria e tyre është vënë në rrugë krejt të ligjshme dhe nuk ka asnjë lidhje me krimin.

Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs personat e tretë, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe duke e gjykuar çështjen në fakt të vendoset rrëzimi i kërkesës së prokurorit për sekuestrimin e pasurisë, duke parashtuar këto shkaqe:

- Kërkesa e prokurorit për vënien në sekuestro është për objekte me vlerë mbi 35 milionë lekë, prandaj kompetente për ta gjykuar nuk është gjyqtari, por gjykata me trup gjykues.

- Familja Troplini është familje bujqësore që nga viti 1992, me mbi 15 krerë lopë, mbi 300 krerë dele, mbi 1000 krerë pula, të gjitha këto të provuara me dokumente shkresore. E gjithë kjo pasuri na përket të gjithëve dhe jo vetëm personit nën hetim Xhevdet Troplini. Edhe objektet e sekuestruara, ish-Ndërmarrja e Peshkimit Durrës, janë pasuri e familjes sonë bujqësore, pasi janë blerë në vitin 2002 dhe paguar me këste duke shitur nga pasuria jonë, të vërtetuara me dokumente zyrtare.

- Pasuria e familjes nuk rrjedh nga burime të kundërligjshme. Gjykata shprehet se edhe vlerat monetare janë të personit nën hetim, Xhevdet Troplinit. Por ato nuk kanë emër, ndonëse janë gjetur në banesë. Nëse ky person është marrë me veprimtari kriminale, të identifikohet pasuria e tij e lidhur me krimin dhe të ndahet nga ajo që i përket familjes bujqësore.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 25.10.2006, vendosi ta kalojë çështjen për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, për të unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me sa më poshtë:

1. Të sqarohet dhe të interpretohet kuptimi i nenit 4 pika 3 dhe nenit 28 pika 1 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar". Sipas këtij ligji dhe, më posaçërisht, në kuptim e zbatim të dispozitave të mësipërme, cila do të jetë gjykata kompetente për hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive: gjykata penale për krime të rënda, duke hetuar e gjykuar çështjen sipas rregullave të procedurës civile, apo është gjykata civile. Nëse është Gjykata e Krimeve të Rënda, a mund të veprojë si gjykatë civile? Po kështu, nëse ky gjykim do të jetë në kompetencë të Gjykatës për Krime të Rënda, a do të gjykohet çështja me një gjyqtar, në bazë të nenit 13 pika 3 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës Penale, si një kërkesë e prokurorit e bërë në fazën e hetimit paraprak, apo do të gjykohet në bazë të kriterëve ligjore të përcaktuara nga neni 35/2 të Kodit të Procedurës Civile.

2. Cili është kuptimi dhe interpretimi i neneve 7 e 10 të këtij ligji, nëse sekuestrimi paraprak (neni 7) dhe sekuestrimi (neni 10) janë faza të domosdoshme të një procesi që i paraprin konfiskimit, apo janë masa të shpëputura nga njëra-tjetra dhe si të tilla veprojnë në mënyrë të pavarur.

3. Nëse konfiskimi bëhet vetëm në rastet pasi më parë është vendosur pezullimi dhe sekuestro

(neni 9 e 10), apo edhe në rastet kur më parë është vendosur vetëm sekuestro paraprake, neni 7.

4. Cili është kuptimi i "pezullimit të përkohshëm të administrimit dhe disponimit të pasurive" (neni 9) dhe lidhja e tij me sekuestrimin (neni 10). Nëse janë hallka të një procesi që duhen zbatuar patjetër për të arritur të konfiskimi, apo mund të veprojnë pavarësisht nga njëra-tjetra.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Gani Dizdari dhe Thimjo Kondi; prokurorin Artur Selmani, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; mbrojtësin e personit nën hetim Xhevdet Troplini dhe të personave të tretë, avokatin Skënder Demiraj, i cili kërkoj prishjen e vendimeve të dhëna në të dy shkallët e gjykimit dhe duke e gjykuar çështjen në fakt rrëzimin e kërkesës së prokurorit për sekuestrimin e pasurisë; dhe pasi e bisedoi çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.37, datë 10.7.2006 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, është dhënë në respektim të ligjit, prandaj duhet të mbetet në fuqi.

Nga gjykimi i çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, rezultojnë të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Në datën 14.10.2005 Prokuroria pranë Gjykatës së Barit Itali ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme kopjen e dosjes penale që lidhet me veprimtarinë kriminale të shtetasit shqiptar Xhevdet Troplini. Sipas akteve të vëna në dispozicion nga autoritetet italiane, rezultonte që ky shtetas, në bashkëpunim me të tjerë, të kenë trafikuar në drejtim të Italisë lëndë narkotike të tipit heroinë në sasinë prej 11 kg, e cila është sekuestruar nga autoritetet italiane në datën 8.3.2004.

Mbi këtë bazë Prokuroria e Krimeve të Rënda, me vendimin e saj të datës 2.11.2005, ka filluar procedimin penal nr.88, në ngarkim të shtetasit Xhevdet Troplini, duke e akuzuar për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/a paragrafi 3 i Kodit Penal. Në vijim të procedimit penal, ndaj personit nën hetim Xhevdet Troplini, në datën 17.1.2006, gjykata ka vendosur masën e sigurimit arrest në burg, ndërkohë që po në këtë datë, pas kryerjes së kontrollit në banesën e tij, i janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale 23.726.600 lekë, 20.505 euro dhe 203 dollarë amerikanë.

Në rrethana të tilla, ndërkohë që vijon procedimi penal, duke e konsideruar personin nën hetim, Xhevdet Troplini, edhe si "person të dyshuar", subjekt të nenit 3 pika 1 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", Prokuroria e Krimeve të Rënda ka filluar e zhvilluar verifikimin dhe hetimin mbi pasuritë e disponuara prej tij sipas kritereve dhe procedurave të këtij ligji.

Fillimisht, prokurori ka kërkuar para gjykatës sekuestrimin paraprak të një pasurie të paluajtshme që rezulton të jetë privatizuar dhe në pronësi të personit nën hetim Xhevdet Troplini, e cila përbëhet nga objekte të ish-Ndërmarrjes së Rritjes dhe Zënies së Peshkut Durrës, me një sipërfaqe të përgjithshme 9900 m².

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr.39, datë 10.4.2006 ka shqyrtuar kërkesën e prokurorit dhe ka vendosur sekuestrimin paraprak të kësaj pasurie të paluajtshme, duke caktuar kryesisht edhe datën e seancës gjyqësore (26.04.2006) për shqyrtimin e vendosjes së masës së sekuestros, sipas ligjit të lartpërmendur.

Gjatë shqyrtimit të çështjes në këtë seancë gjyqësore, prokurori i ka kërkuar gjykatës jo vetëm që të konfirmojë sekuestron paraprak, pra të vendosë masën e sekuestros mbi pasuritë e paluajtshme, objektet e ish-Ndërmarrjes së Rritjes dhe Zënies së Peshkut Durrës, por edhe sekuestrimin, sipas procedurave dhe standardeve të këtij ligji, të vlerave monetare prej 23.726.600 lekë, 20.505 euro e 203 dollarë amerikanë, mbi të cilat në procedimin penal ishte vendosur më parë masa e sekuestrimit të tyre si prova materiale.

Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me vendimin nr.39, datë 12.6.2006, ka vendosur të pranojë kërkesat e prokurorit, duke sekuestruar pasuritë e lartpërmendura. Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, me vendimin nr.37, datë 10.7.2006, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së

shkallës së parë duke çmuar të pambështetura në prova dhe në ligj pretendimet e personit nën hetim Xhevdet Troplini dhe ato të personave të tretë të parashtruara në ankimet përkatëse drejtuar kësaj gjykate.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, kanë ushtruar rekurs si person nën hetim Xhevdet Troplini, ashtu edhe personat e tretë, duke i parashtruar Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë pretendime se gjykatat kanë zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin material dhe procedural.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi ka shqyrtuar çështjen në seancën gjyqësore të datës 25.10.2006, ka vendosur ta kalojë çështjen për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, për të unifikuar praktikën gjyqësore.

Pasi shqyrtuan çështjen, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i gjejnë të pambështetura në ligj pretendimet e parashtruara në rekurs nga personi nën hetim dhe atë të personave të tretë dhe vlerësojnë të drejtë e të bazuar në ligj vendimin e Gjykatës së Apelit së Krimeve të Rënda.

Sipas rekursit, referuar nenit 4 pika 3 dhe nenit 28 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, ligji procedural i zbatueshëm në këtë gjykim është ai procedural civil, në të gjitha aspektet e tij, përfshirë kompetencën e gjykatës civile për gjykimin e çështjes, përbërjen e detyrueshme kolegjiale të trupës gjyqësore (sipas nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile). Por edhe nëse është gjykata penale, përsëri përbërja duhet të jetë kolegjiale, pra nga gjykata e krimeve të rënda gjykimi duhet të bëhet me 5 gjyqtarë.

Lidhur me këtë pretendim, të ngritur edhe në ankim, Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda ka arsyetuar se nuk jemi përpara një padie civile, por një kërkesë për vendosje të një mase provizore sekuestro. Sipas nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata e krimeve të rënda i shqyrton kërkesat e prokurorit me gjyqtar të vetëm, sikurse është edhe kjo kërkesë e prokurorit e bërë në fazën e hetimit paraprak. Prandaj edhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda i gjykon këto kërkesa me tre gjyqtarë.

Në këtë kontekst, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka shtruar si çështje për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, për efekte të unifikimit të praktikës gjyqësore, sqarimin dhe interpretimin e kuptimit të nenit 4 pika 3 dhe nenit 28 pika 1 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se, pavarësisht nga formulimi dhe gjuha e përdorur, në përmbajtje pika 3 e nenit 4 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 përbën një normë me karakter rregullues të përgjithshëm që duhet kuptuar e interpretuar jo në mënyrë literale, por sipas qëllimit dhe vullnetit të ligjvënësit, duke marrë parasysh edhe përmbajtjen në tërësi të dispozitave të këtij ligji.

Ky ligj lidhet me zbatimin e një regjimi juridik të posaçëm për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që burojnë apo lidhen me disa nga fenomenet më të rënda kriminale, me një lloj procedimi të posaçëm të natyrës parandaluese dhe goditëse ndaj këtyre fenomeneve. Ndonëse nuk është procedim penal, me anë të të cilit caktohen rregulla për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, për hetimin dhe gjykimin e veprave penale, etj., në çdo rast, procedimi parandalues është i lidhur me ekzistencën dhe përfundimet e atij penal.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se, në kuptim dhe interpretim të pikës 3 të nenit 4 përveç parimeve dhe rregullimeve të parashikuara shprehimisht në këtë ligj, hetimi dhe gjykimi parandalues mbështetet, sipas referimeve konkrete, apo sipas rastit, edhe në norma të procedimit administrativ, civil dhe penal që lidhen apo i shërbejnë zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor në procedimin parandalues. Pra si rregull zbatohen kriteret, procedurat, kompetencat e parashikuara apo të referuara nga ky ligj dhe, si plotësim e përjashtim, ato të dispozitave të tjera ligjore. Ndonëse ky është një gjykim i veçantë, thelbësorë është që nëpërmjet njohjes e zbatimit të këtyre dispozitave të garantohet zhvillimi i një procesi të rregullt ligjor.

Gjithashtu, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se në pajtim me qëllimin dhe rregullimin e përgjithshëm të dispozitës së nenit 4 pika 3 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, neni 28 është pikërisht njëra nga dispozitat e këtij ligji që bën një referim konkret për zbatimin në gjykimin parandalues të disa prej rregullave të parashikuara nga Kodit të Procedurës Civile, vetëm lidhur me disa elemente të përmbajtjes dhe procedurës së paraqitjes së ankimit ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, si dhe për aspekte të caktuara të shqyrtimit të çështjes në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (neni 424/3 i Kodit të Procedurës Penale).

Këto rregulla procedurale civile janë të zbatueshme në gjykimin parandalues vetëm në shkallë të dytë dhe vetëm për atë që janë të pajtueshme e në funksion me natyrën dhe qëllimin e këtij lloji procedimi. Përveç kësaj, “afatet” dhe “kushtet e gjykimit” sipas Kodit të Procedurës Civile, të treguara në pikën 1 të nenit 28 të ligjit, gjejnë zbatim atëherë kur nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj.

Prandaj në këtë dispozitë parashikohet, në mënyrë origjinale, shprehimisht se: “ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit”, pra qoftë i ndërmjetëm (sekuestro apo pezullimi i administrimit), qoftë përfundimtar (konfiskimi). Ky rregullim përjashton zbatimin e parimit të përgjithshëm të pezullimit të ekzekutimit të një vendimi themeli në gjykimin civil (neni 449 i Kodit të Procedurës Civile), apo në atë penal (neni 417 i Kodit të Procedurës Penale), duke aplikuar në çdo rast vetëm rregullin e mospezullimit të ekzekutimit sikurse ndodh me vendimet e ndërmjetme (neni 471 i Kodit të Procedurës Civile) apo të masës së sigurimit (neni 276 i Kodit të Procedurës Penale).

Po kështu, nisur nga natyra, qëllimi, objekti i ndryshëm i hetimit e gjykimit krahasuar me procedimin penal, si dhe nga dispozitat e neneve 4/3 dhe 28 të ligjit, në gjykimin parandalues nuk gjen zbatim parimi i mosrëndimit të pozitës së personit (të dyshuar apo të tretë) që ka paraqitur ankimin (neni 425/3 i Kodit të Procedurës Penale), parimi procedural penal për shqyrtimin në tërësi të çështjes në apel pa u kufizuar vetëm në shkaqet e ankimit (neni 425/1 i Kodit të Procedurës Penale). Përkundrazi, gjykata e apelit, në gjykimin parandalues, i jep përgjigje vetëm çështjeve të ngritura në ankim (neni 6, 20, 28, 29 i Kodit të Procedurës Civile), afati i paraqitjes së ankimit është 15 ditë dhe jo 10 ditë si në procedimin penal, etj.

Në rekurs, personi nën hetim dhe personat e tjerë kanë ngritur pretendimin se çështja objekt gjykimi është në juridiksionin civil dhe në kompetencën e gjykatës civile, pretendim i cili nuk është pranuar si i mbështetur në ligj nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

Njëkohësisht, Kolegjeve të Bashkuara i janë parashtruar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë për shqyrtim për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore çështja se cila është gjykata kompetente për hetimin e gjykimin e masave parandaluese pasurore të sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive: gjykata civile apo gjykata penale për krime të rënda, duke hetuar e gjykuar çështjen sipas rregullave të procedurës civile. Nëse është Gjykata e Krimeve të Rënda a mund të veprojë ajo si gjykatë civile?

Gjykata civile nuk mund të ketë juridiksion dhe kompetence për gjykimin e masave parandaluese sipas ligjit nr.9284, datë 30.9.2004. Ky ligj nuk ka për objekt çështje të së drejtës civile, konflikte mbi marrëdhëniet pasurore e personale jopasurore mes subjekteve të së drejtës (civile), pra nuk trajton zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile, administrative, etj., ndërmjet tyre, në kuptim të nenit 1 dhe 36 të Kodit të Procedurës Civile. Ky ligj synon zbatimin e masave të natyrës parandaluese e goditëse që drejtohen ndaj pasurisë së pajustificuar ligjërisht të një kategorie të posaçme të personave shoqërisht të rrezikshëm, për shkak të pjesëmarrjes në veprimtari kriminale, të njohura edhe për konvencion si fenomene të krimit të organizuar.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se masat parandaluese pasurore të parashikuara nga ky ligj, në parim, mund të gjejnë zbatim pasi ka filluar një procedim penal, ashtu edhe pas përfundimit të tij. Zbatimi i tyre është i lidhur me ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme, pra të dyshimit të arsyeshëm për kryerjen nga personi i dyshuar të njëres prej veprave penale të treguara në nenin 3 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, apo edhe me vërtetimin e fajësisë së tij për kryerjen e këtyre veprave penale. Pra, këto masa zbatohen ndaj pasurisë së një personi të dyshuar, i cili, si rregull, i është nënshtruar apo i nënshtrohet hetimit a gjykimit për kryerjen e këtyre veprave penale. Madje, në këto raste, kur ka të dhëna të bazuara për kryerjen e një veprimtarie kriminale-të veprave penale të lartpërmendura-masat parandaluese pasurore gjejnë zbatim jo vetëm ndaj personit të dyshuar, por edhe ndaj familjareve, të afërmeve e personave të tjerë të tretë të lidhur me të, sipas kritereve dhe kushteve të caktuara në këtë ligj të posaçëm.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se, duke qenë se masat parandaluese pasurore janë të lidhura me dyshimin për kryerjen nga personi të një vepre penale (neni 3 pika 1 e ligjit nr.9284, datë 30.9.2004), me dyshimin dhe prezumimin për zotërimin e prejardhjen e paligjshme të pasurisë për shkak e në lidhje me këtë veprimtari kriminale, si dhe me ekzistencën e një procedimi penal, me ecurinë dhe përfundimet e tij, atëherë edhe në procedimin parandalues hetimi dhe gjykimi i çështjes së masave parandaluese pasurore janë kompetencë e gjykatës penale.

Në gjykimin parandalues, krahas dispozitave të posaçme të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004,

njëkohësisht, gjejnë zbatim edhe norma të caktuara të ligjit procedural civil dhe të atij procedural penal. Prandaj, në këtë kuptim, gjykimin e masave preventive sipas këtij ligji nuk mund ta zhvillojë gjykata civile, por vetëm ajo penale.

Nga ana tjetër, ndonëse nuk tregohet në mënyrë të shprehur gjykata penale dhe prokuroria përkatëse kompetente, ligji nr.9284, datë 30.9.2004 nuk ndalon që shqyrtimin e kërkesave të prokurorit për vendosjen e masave parandaluese të jenë në kompetencë të gjykatës së krimeve të rënda. **Për sa kohë në ligj nuk parashikohet ndryshe, atëherë për gjykimin e këtyre masave do të jetë kompetente gjykata, e cila, sipas Kodit të Procedurës Penale (neni 75/a), ka në kompetencë gjykimin e krimeve të rënda, si dhe të atyre veprave penale (neni 3 pika 1 e ligjit) për të cilat gjejnë zbatim masat parandaluese të parashikuara nga ligji nr.9284, datë 30.9.2004. Pra, kompetente për gjykimin e kërkesës për vendosjen e masave parandaluese është gjykata e krimeve të rënda.**

Në rekursin e personit nën hetim dhe personave të tjerë parashtrohet pretendimi se përbërja e gjykatave në të dy shkallët e gjykimit është në kundërshtim me ligjin, sepse si gjykatë civile duhet të shqyrtonte me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë në shkallë të parë dhe me pesë gjyqtarë në shkallë të dytë.

Kolegji Penal, për efekte të unifikimit të praktikës gjyqësore, ka shtruar përpara Kolegjeve të Bashkuara pyetjet se nëse ky gjykim është në kompetencë të Gjykatës për Krime të Rënda, a do të gjykohej me një gjyqtar në bazë të nenit 13 pika 3 paragrafi "2" të Kodit të Procedurës Penale, si një kërkesë e prokurorit e bërë në fazën e hetimit paraprak, apo gjejnë zbatim kriteret ligjore për përbërjen kolegjiale të gjykatës të përcaktuara nga neni 35/2 i Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, për këtë çështje arsyeton se: "Neni 35/2 i Kodit të Procedurës Civile parashikon rastet kur paditë gjykohen me trup gjyqësor kolegjial në shkallë të parë. Por çështja objekt gjykimi nuk është padi, por kërkesë për vendosje të një mase provizore sekuestro. Ndërsa sipas nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata e krimeve të rënda i shqyrton kërkesat e prokurorit me gjyqtar të vetëm, sikurse është kjo kërkesë e prokurorit e bërë në fazën e hetimit paraprak. Prandaj edhe gjykata e apelit për krimet e rënda i gjykon këto kërkesa me tre gjyqtarë."

Kolegjet e Bashkuara, për të arritur në përfundimet e tyre mbi këtë pretendim dhe për qëllime të njësimi të praktikës gjyqësore, çmojnë të nevojshme interpretimin sistematik të dispozitave të lartpërmendura në lidhje me qëllimin, përmbajtjen dhe zbatimin në tërësi të dispozitave të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar".

Sipas nenit 13 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata penale gjykon me trupë kolegjiale përveç kur, shprehimisht, ligji kërkon një përbërje me trup gjykues monokratik. E kundërta sanksionohet në gjykimin civil, ku gjykata e shkallës së parë shqyrton çështjen me gjyqtar të vetëm përveç kur në Kodit të Procedurës Civile (neni 35), apo në ligje të veçanta parashikohet shprehimisht gjykimin me trup kolegjial.

Ndërsa në gjykimin parandalues, për sa kohë në ligj nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, shqyrtimi i çështjes në gjykatën e shkallës së parë për krimet e rënda bëhet me trup gjykues monokratik, ndërsa në shkallë të dytë me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

Gjykimi parandalues nuk kushtëzohet nga parimet dhe rregullat e shqyrtimit të kërkesave të palëve gjatë hetimeve paraprake (neni 13/2/b i Kodit të Procedurës Penale), sepse gjykimi parandalues është një procedim autonom, nuk është pjesë e ushtrimit të ndjekjes penale, pra nuk është as fazë hetimesh paraprake e procedimit penal. Në këtë kuptim, megjithëse ka zgjidhur drejt çështjen, nuk përbën një interpretim të drejtë të ligjit arsyetimi i gjykatës së apelit që referon gjykimin e saj në lidhje me fazën e hetimeve paraprake të procedimit penal. Njëkohësisht, procedimi parandalues është autonom edhe në raport me procedimin civil, pasi nuk ka për objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile. Prandaj përbërja e trupit gjykues në procedimin parandalues nuk mbështetet, nuk referohet drejtpërdrejt në nenin 13 të Kodit të Procedurës Penale apo në nenin 35 të Kodit të Procedurës Civile.

Prandaj, **Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se gjykimi i kërkesave për vendosjen e masave parandaluese sipas ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 realizohet në gjykatën për krimet e rënda nga gjyqtari i vetëm në shkallë të parë dhe trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë në shkallë të dytë.** Kjo përbërje e gjykatës vlerësohet se respekton dhe është në pajtim të plotë me standardet për garantimin e një procesi të rregullt ligjor edhe në gjykimin parandalues.

Ky përfundim gjen mbështetje edhe në praktikën tonë gjyqësore lidhur me shqyrtimin e

kërkimeve të veçanta për vendosjen e masave preventive që drejtohen ndaj pasurisë, në mungesën e parashikimit të shprehur në ligj për gjykimin e këtyre çështjeve me trup kolegjal, pavarësisht nga vlera e pasurisë (Kodi i Procedurës Civile), apo në parashikimin e shprehur për shqyrtimin e tyre nga gjyqtari i vetëm (Kodi i Procedurës Penale).

Gjithashtu, duke qenë se, sipas neneve 19 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, gjykata e krimeve të rënda ka në kompetencë edhe çështje që lidhen me administrimin e sendit të sekuestruar, **Kolegjet e Bashkuara çmojnë se nuk përbën shkelje të ligjit që e njëjta gjykatë të shqyrtojë e vendosë si për kërkesat lidhur me masat parandaluese pasurore, ashtu edhe për ato që kanë të bëjnë me çështje të administrimit të pasurive të sekuestruara në zbatim të këtyre masave, për shkak se vendimet që jepen lidhur me këto të fundit nuk janë të tilla që mund të ndikojnë në motivimin ligjor dhe në fakt të vendimit eventual për konfiskimin e pasurive të sekuestruara.**

Kolegjet e Bashkuara, gjatë shqyrtimit të çështjes objekt gjykimi, çmuan të vënë në diskutim dhe të shprehen lidhur me ekzistencën dhe respektimin e ligjit përsa i përket autonomisë dhe lidhjeve eventuale të procedimit parandalues dhe procedimit penal.

Ligji nr.9284, datë 30.9.2004 ka për objekt zbatimin e masave parandaluese pasurore ndaj personave të dyshuar për kryerjen e një kategorie të caktuar veprash penale. Në këtë kuptim, procedimi parandalues sipas këtij ligji është i lidhur domosdoshmërisht me qenien e një procedimi penal, pavarësisht se në cilën fazë ndodhet ky i fundit, apo nëse ka përfunduar.

Masat ndaj pasurisë (sekuestrimi, pezullimi i përkohshëm i administrimit dhe disponimit, konfiskimi), që vendosen në procedimin parandalues nuk mbështeten, nuk i referohen, nuk janë pjesë dhe as nuk i nënshtrohen ndonjë procedure vleftësimi në procedimin penal. Në këtë kuptim, përveç të tjerave, procedimi parandalues vijon në mënyrë autonome, pavarësisht nga ecuria e hetimit paraprak apo shkalla e shqyrtimit gjyqësor të çështjes penale, sepse nuk është pjesë e fazës së hetimeve paraprake në procedimit penal, nuk është një masë e sigurimit pasuror në zbatim të neneve 270-276 të Kodit të Procedurës Penale.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se procedimi parandalues sipas ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, është autonom në raport me procedimin penal (dhe atë civil). Procedimi preventiv mund të fillojë, vazhdojë e përfundojë, si gjatë ashtu edhe pas përfundimit të një procedimi penal. Nga ana tjetër, duke qenë procedime autonome ato nuk janë procedime të tilla që përjashtojnë fillimin, vazhdimin dhe përfundimin e njëra-tjetrës, përsa kohë pretendohet a vërtetohet se ka një person të dyshuar në kuptim të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 për kryerjen e një veprë penale, ndaj të cilit është duke u zhvilluar apo ka përfunduar një procedim penal.

Autonomia e procedimit penal dhe atij parandalues rezulton edhe nga përmbajtja e dispozitës së nenit 27 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004. Kjo dispozitë ndër të tjera konfirmon edhe faktin që këto dy procedime nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, përkundrazi. **Nga dispozita e nenit 27 rezulton se procedimi penal ka përparësi, përderisa masat përkatëse pasurore të vendosura gjatë gjykit parandalues mbeten të pezulluara, nuk ekzekutohen, derisa të përfundojë procedimi penal dhe gjykata penale të shprehet, ndërmjet të tjerave, edhe për masat e sigurimit pasuror të vendosura në atë gjykim penal.**

Në zbatim të nenit 27, masat pasurore të vendosura në procedimin parandalues shuhen vetvetiu vetëm nëse gjykata penale vendos konfiskimin për të njëjtat pasuri. Por këto masa nuk shuhen në këtë mënyrë nëse gjykata e procedimit penal nuk vendos konfiskimin, apo vendos heqjen e masave të sigurimit pasuror. Ato mbeten në fuqi, mund të kthehen në masa konfiskimi, apo mund të rishikohen pas shqyrtimit autonom të çështjes nga gjykata e procedimit parandalues, e cila çmon në tërësi të gjitha rrethanat dhe provat e paraqitura nga subjektet pjesëmarrëse në gjykimin parandalues, përveç atyre që kanë të bëjnë me cilësinë e personit të dyshuar, të rezultuara në përfundimet e arritura nga gjykata e procedimit penal lidhur me dhënien e një vendimi dënimi, pafajësie a pushimi të çështjes në ngarkim të personit të dyshuar.

Në rekurs, personi i dyshuar (nën hetim) dhe personat e tjerë kanë pretenduar se, në hetimin dhe gjykimin e çështjes, prokurori dhe gjykata, megjithëse kishin detyrimin të vërtetësonin të kundërtën, nuk kanë bërë verifikimin e pretendimeve të tyre lidhur me origjinën e ligjshme të pasurisë së sekuestruar.

Lidhur me këtë pretendim, gjykatat e shkallës së parë dhe ajo e apelit për krimet e rënda kanë arsyetuar se, sipas nenit 13 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, personi në hetim dhe personat e tjerë kanë

barrën e provës të provojnë se pasuria e tyre është vënë në mënyrë të ligjshme. Të ardhurat e tyre, edhe sipas akteve e provave që kanë paraqitur vetë në gjykim, janë shumë më të ulëta sesa vlera e pasurive të vendosura nën masën e sekuestros. Pra, ata nuk provuan se pasuritë objekt gjykimi u përgjigjen të ardhurave të deklaruara.

Në këtë kontekst, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se në ligjin nr.9284, datë 30.9.2004 parashikohen rregulla të posaçme mbi kompetencat dhe procedurën, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedimin parandalues, ndërmjet të cilave evidentohet përcaktimi i barrës së provës së personave të dyshuar dhe personave të tjerë lidhur me justifikimin e origjinës së ligjshme të pasurisë së tyre.

Për efekte të gjykimit parandalues, nëse prokurori arrin të vërtetojë se ndaj një personi ka një procedim penal, masa sigurimi apo një vendim dënimi për njërën nga veprat penale të parashikuara nga neni 3 pika 1 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, atëherë kjo përbën provë me vlerë të plotë për të vërtetuar para gjykatës “dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova” për kryerjen e këtyre veprave penale, pra subjekti i procedimit penal ka edhe cilësitë e “personit të dyshuar” (nenet 1, 2, 3 të ligjit).

Sa më sipër sjellin Kolegjet e Bashkuara në përfundimet se i përket prokurorit barra e provës për të vërtetuar në gjykatë se një person në hetim apo i dënuar përmbush kushtet për t’u cilësuar si “person i dyshuar” për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004.

Në procedimin parandalues mjafton të vërtetohet dyshimi i arsyeshëm për qenien si “person i dyshuar”, mundësia e zotërimit të pasurive prej tij dhe mosjustifikimi i prejardhjes së ligjshme të këtyre pasurive në raport me veprimtarinë, sjelljen, të ardhurat dhe mënyrën e jetesës, me kohën dhe llojin e veprës që i atribuohet, apo vërtetohet se ka kryer personi i dyshuar. **Por në gjykimin dhe dhënien e vendimit për vendosjen e masave pasurore, gjykata nuk mund t’i hyjë bazueshmërisë së përfundimeve që janë arritur në procedimin penal lidhur me ato elemente që në fakt justifikojnë vendosjen e masës preventive pasurore, veçanërisht përsa i përket kualifikimit të personit si “person i dyshuar”.**

Në këtë aspekt, në objektin e hetimit dhe gjykimit preventiv është vërtetimi i “dyshimit të arsyeshëm” për pjesëmarrje, kryerje të veprave penale sipas nenit 3 të ligjit nr.9284, por jo edhe vërtetimi lidhjes shkakësore të veprimeve të tij me pasojat e ardhura për efekt të përgjegjësisë penale të tij. Ndërsa procedimi penal është i lidhur me një fakt të caktuar që përbën, apo i atribuon personit kryerjen e një vepre penale, procedimi preventiv është i lidhur me vlerësimin e rrethanave, rrezikshmërisë së një personi të dyshuar, që shfaqet edhe në veprimtari, sjellje e qëndrime të cilat jo domosdoshmërisht janë të lidhura me përgjegjësinë penale, domethënë përbëjnë vepër penale.

Prandaj gjykata preventive, për qëllime të vendosjes së masës parandaluese pasurore, duhet të shqyrtojë dhe vlerësojë në mënyrë autonome të gjitha faktet, rrethanat, indiciet, etj., për të nxjerrë përfundimet e saj mbi elementet që mbështesin në ligj e në fakt vendosjen e masës preventive pasurore.

Nga ana tjetër, në kuptim të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, në ndryshim nga procedimi penal, prezumohet se pasuritë e personit të dyshuar kanë një lidhje me pjesëmarrjen, kryerjen e veprave penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të këtij ligji. **Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se personi i dyshuar (neni 3, pika 1) dhe personat e tjerë (neni 3, pika 2 dhe neni 8) kanë barrën e provës për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurisë së tyre, për të provuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale a investim të tyre dhe, vetëm për “personat e tjerë” të provojnë se, jo vetëm nga pikëpamja formale, por edhe në fakt, nuk jemi përpara zotërimit në çdo mënyrë të këtyre pasurive prej personit të dyshuar.**

Por, për zbatimin e drejtë të ligjit, mbështetur në hetimet e kryera, edhe prokurori ka detyrime për të parashtruar kërtime të motivuara dhe prova mbështetëse përpara gjykatës, lidhur me identifikimin e pasurive të personit të dyshuar e të personave të tjerë, të tregojë nga ana e tij se ka bazë për dyshime të arsyeshme dhe, në këtë mënyrë të dhëna, prova të mjaftueshme për efekte të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, gjë që motivon ekzistencën e prezumimit që buron nga ligji nr.9284, datë 30.9.2004 dhe, si rezultat, kërkesën për zbatimin e masave pasurore të sekuestrimit, pezullimit të përkohshëm dhe konfiskimit, duke i kërkuar gjykatës t’i kalojë në këtë mënyrë edhe barrën e provës personave të dyshuar dhe personave të tjerë (neni 8, neni 13). Nga ana e saj, gjykata

duhet të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të mbështetur në prova dhe në ligj.

Në zbatim të normave materiale e procedurale penale, gjykata që shqyrton një çështje penale, me dhënien e vendimit të dënimit dhe, kur janë rrethanat, edhe në rast të një vendimi për pushimin e çështjes apo të pafajësisë, mund të urdhërojë konfiskimin e pasurive. Masa e konfiskimit jepet nëse vërtetohet se ka një lidhje shkakësore, logjike e kronologjike, ndërmjet pasurisë që konfiskohet dhe veprës penale të kryer.

Ndryshe nga standardet e të provuarit dhe përgjegjësisë në dhënien e një vendimi penal, përfshirë urdhërimin për konfiskimin ose jo të sendeve të sekuestruara, në procedimin parandalues, sipas ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, vendosja e masës pasurore ka në themel të saj mundësinë, dyshimin e arsyeshëm, të mbështetur në të dhëna të mjaftueshme që rezultojnë nga tërësia e provave të marra dhe të verifikuara gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se ligji ka parashikuar prezumimin që, për shkak e pasojë të kryerjes së një veprimtarie kriminale (vepre penale) e cila i atribuohet apo është vërtetuar kundrejt personit të dyshuar, kemi të bëjmë me pasuri të cilat lidhen apo janë produkt i veprimtarisë kriminale, a përbëjnë përdorimin e tyre, të zotëruara direkt apo indirekt nga personi i dyshuar, të cilat formalisht, fiktivisht mund të mbahen edhe nga persona të tjerë (neni 3, pika 2, dhe neni 8), të fituara në mënyrë të paligjshme, pra që nuk justifikohen ligjërisht dhe që janë në shpërpjesëtim vleror me veprimtarinë e mundësitë ekonomike, me të ardhurat e deklaruar për qëllime fiskale, etj., nga ana e këtyre personave.

Pra, në ndryshim nga procedimi penal, gjykimi parandalues mbështetet në dyshime të arsyeshme, prova të mjaftueshme e prezumime, duke iu ngarkuar personit të dyshuar dhe personave të tjerë barra e provës për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Në procedimin parandalues nuk ka vend për vërtetimin domosdoshmërisht nga prokurori e gjykata të lidhjes shkakësore, të drejtpërdrejtë, të dukshme e imediate, logjike e kronologjike, ndërmjet pasurisë, prejardhjes së saj dhe veprës penale për të cilën së paku ekziston dyshimi i arsyeshëm si e kryer nga personi i dyshuar.

Në rekurs, si personi i dyshuar dhe personat e tjerët kanë parashtruar edhe pretendime për zbatim të gabuar të ligjit material, si dhe për çmimin e provave nga gjykata. Sipas tyre është e vërtetë se pasuritë objekt i masës së sekuestros janë në emër të tij, por ato nuk janë produkt i veprës penale, as investim i tyre, por vijnë nga puna e ligjshme e tij dhe e familjes. Ish-Ndërmarrja e Rritjes dhe e Zënies së Peshkut është blerë përpara vitit 2004, kohë kur akuza pretendon se ai ka kryer veprën penale. Pasuria nuk i përket vetëm atij, por të gjithë familjes bujqësore. Përveç kësaj personat e tretë pretenduan se në çdo rast pjesët takuese të tyre nuk duhet të sekuestrohen, sepse, përsa i përket së paku pjesës së tyre, ato janë vënë në rrugë të ligjshme, përfshirë vlerat monetare.

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e Apelit për Krimet e Rënda, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të provave dhe pretendimeve të pjesëmarrësve në gjykim, kanë çmuar dhe arritur në përfundimin se shtetasi Xhevdet Troplini është person nën hetim në gjendje arresti në burg në procedimin penal në ngarkim të tij për kryerjen e veprës penale të trafikimit të narkotikëve (neni 283/a paragrafi i tretë i Kodit Penal). Kjo vepër penale përfshihet në nenin 3 pika 1/ç të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, prandaj edhe pasuritë e rezultuara në emër të tij duhet t'u nënshtrohen masave të parashikuara nga ky ligj. Po kështu, personat e tretë bëjnë pjesë në rrethin e personave të dyshuar, ndaj edhe janë subjekte të zbatimit të ligjit.

Gjykatat kanë çmuar se nga të gjitha provat shkresore dhe aktet zyrtare rezulton se objektet e ish-Ndërmarrjes së Peshkimit të jenë blerë nga personi nën hetim në vitin 2002 dhe 2003 dhe të jenë në pronësi të tij. Ndërkohë, në procedimin penal janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale në banesën e personit nën hetim vlera monetare që, sipas ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, i nënshtrohen edhe masës së sekuestros në procedimin parandalues.

Sipas gjykatave, pretendimet e personit në hetim dhe personit të tretë nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe në prova, sepse nuk provohet që kemi të bëjmë me një familje bujqësore me tiparet e saj ligjore dhe ekonomike. Nëse pasuritë do të ishin pronë e familjes bujqësore ato do të figuronin në emër të personit tjetër Shefqet Troplini dhe jo në emër të personit të dyshuar nën hetim Xhevdet Troplini. Jo vetëm në këtë rast, por për të gjitha pasuritë objekt i sekuestros në këtë gjykim, personi nën hetim dhe personat e tjerë nuk provuan se janë të justifikuara me të ardhurat e deklaruar nder vite deri në kohën e gjykitimit.

Së fundi, gjykatat kanë çmuar se personi në hetim është i dyshuar për një veprimtari kriminale, e cila nga provat e shqyrtuara, pra nga të dhënat e hetimit, rezulton se ka dyshime të bazuara që kjo veprimtari ka filluar përpara vitit 2004 dhe vlera e trafikimit të narkotikëve e ka kaluar shumë 800.000 euro. Ky është një dyshim i arsyeshëm dhe përfundimet në këtë gjykim mund të ndryshojnë vetëm nëse në procedimin penal rezulton se rrethanat janë të ndryshme nga ato që pranon gjykata.

Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit për Krime të Rënda janë të mbështetura në ligj dhe, nisur nga arsyetimi i rekuruesve e qëndrimi përkatës i gjykatave në lidhje me pasuritë që mund të jenë objekt i masave pasurore preventive, në vijim çmojnë të shprehen lidhur me disa aspekte thelbësore të tyre për efekte të unifikimit të praktikës gjyqësore.

Ligji nr.9284, datë 30.9.2004 parashikon se masat parandaluese pasurore ndaj personave të dyshuar zbatohen për pasuritë mbi të cilat, ky i fundit, disponon apo mund të disponojë direkt apo indirekt, vlera e të cilave është e pajustificuar ligjërisht krahasuar me të ardhurat. ose me veprimtaritë ekonomike të deklaruara ose që janë produkt i veprës penale, apo përbëjnë vënien në përdorim të tyre.

Megjithatë, hetimi dhe gjykimi preventiv duhet të jetë më i thelluar në rastin e dyshimit të arsyeshëm, të dhënave të mjaftueshme, për vënien në përdorim (investimin) të pasurive që janë produkt i veprave penale apo në rastin e pasurive që në aspektin formal, në shfaqjen e jashtme, i përkasin personave të tjerë, por në fakt zotërohen nga personi i dyshuar për pjesëmarrjen, kryerjen e veprave penale (neni 3, pika 1).

Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, në rastin e parë, meqenëse vënia në përdorim e pasurive produkt i veprës penale (sipas nenit 287 të Kodit Penal) realizohet edhe me anë të shtimit, rritjes, transformimit, përmirësimit, etj., mbi pasuri që tashmë janë në disponim të ligjshëm të personit të dyshuar, zbatimi i masave parandaluese pasurore duhet të kufizohet në ato vlera të pasurisë që janë arritur si pasojë e vënies në përdorim të pasurisë produkt i veprës penale, pra, vetëm mbi atë pjesë të pasurisë që rezulton të jetë rezultat i rritjes në mënyrë të pajustificuar ligjërisht të saj.

Në rastin e dytë, ekziston prezumimi që mbështetet në dyshimin e arsyeshëm, bazuar në të dhëna të mjaftueshme se, pasuria formalisht i përket personave të tjerë, por në fakt, është në disponim të personit të dyshuar dhe ka një lidhje, rrjedh nga veprimtaria e tij kriminale. Pavarësisht nga ky prezumim, në gjykim duhet të vërtetohet lidhur me çdo pasuri të veçantë, se cilat prej tyre janë apo mund të jenë në kontrollin, disponimin faktik të personit të dyshuar dhe cilat realisht e jo thjesht formalisht në atë të personave të tjerë të treguar në pikën 2 të nenit 3 dhe në nenin 8 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004.

Gjithashtu, për zbatimin e masave pasurore ndaj personave të tjerë në gjykim nuk është e mjaftueshme të vërtetohet thjesht fakti i lidhjes familjare, gjinore, të krushqisë, etj., për të provuar ekzistencën e zotërimit në fakt të pasurisë nga personi i dyshuar dhe vendosjen fiktive të saj në emër të personave të tjerë.

Gjykata, përpara se të vendosë masën pasurore, duhet të verifikojë dhe të arrijë në përfundime të mbështetura në prova se ekziston një shfaqje e jashtme, formale, e zotërimit, titullit të pronësisë së pasurisë në emër të personave të tjerë, ndërkohë që nga tërësia e rrethanave disponimi autonom, efektiv, i pjesshëm a i plotë, direkt a i tërthortë, sikur të ishte pronar i tyre është i personit të dyshuar. Këto prova duhet të përmbajnë të dhëna të mjaftueshme, jo thjesht në trajtën e dyshimeve, indicieve, por edhe fakte e rrethana konkrete, të sakta, të cilat në harmoni me njëra tjetrën përbëjnë prova indirekte që mbështesin këtë prezumim të parashtruar nga prokurori në kërkesën e tij drejtuar gjykatës së procedimit preventiv.

Nëse rezulton e kundërta, duke mos qenë vetë persona të dyshuar sipas këtij ligji, ndaj pasurisë së personave të tjerë nuk mund të gjejnë zbatim masat e parashikuara nga ligji nr.9284, datë 30.9.2004.

Po kështu, duke qenë se personat e tjerë janë subjekte të këtij ligji për shkak të prezumimeve lidhur me personin e dyshuar, këto masa nuk gjejnë zbatim edhe kur vërtetohet se nuk kemi të bëjmë më me një person të dyshuar në kuptim të nenit 3 pika 1 të ligjit, qoftë edhe sikur të ketë rezultuar në hetim e gjykim se personat e tjerë nuk justifikojnë prejardhjen e ligjshme të pasurisë, apo se ajo pasuri është produkt i një vepre tjetër penale.

Në kuptim të nenit 8 dhe 13 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, prokurori ka detyrimin të

parashtrorë përpara gjykatës dhe të kërkojë të shqyrtohen prej saj provat në mbështetje të kërkesës për vendosjen e masës pasurore ndaj pasurisë së personave të tjerë. Mbi këtë bazë, ligji i njeh prokurorit edhe të drejtën që, në mënyrë të motivuar, t'i kërkojë gjykatës të detyrojë personat e tjerë, pra t'u kalojë atyre barrën e provës, që të justifikojnë mënyrën e fitimit, prejardhjen e ligjshme të pasurisë së tyre, se kjo pasuri nuk ka lidhje me veprimtarinë kriminale të personit të dyshuar, se ajo pasuri është në zotërimin efektiv, pra jo në mënyrë fiktive (formale) në emër të personave të tjerë. Sipas këtij ligji ekziston prezumimi se edhe në këto raste kemi të bëjmë me pasuri të fituara në mënyrë të paligjshme nga personi i dyshuar. Në këtë mënyrë rrjedh, formësohet, edhe prezumimi se pasuri të cilat formalisht janë në emër të personave të tjerë, në fakt, janë në zotërimin direkt a të tërthortë të personit të dyshuar për kryerjen e veprave penale të treguara në nenin 3 pika 1 të ligjit.

Nga ana tjetër, në interpretim dhe zbatim të drejtë të ligjit, në rastin kur rezulton se personi i dyshuar zotëron një numër pasurish, masa preventive pasurore nuk vendoset vetvetiu mbi të gjitha pasuritë e tij, por çmohet e vendoset për secilën prej tyre dhe vetëm për ato që, nga hetimi dhe gjykimi, rezulton se nuk u justifikohet origjina, prejardhja e ligjshme. Kjo për shkak se nuk mund të përjashtohet mundësia që një person i dyshuar sipas këtij ligji, të disponojë edhe pasuri të fituara në mënyrë të ligjshme.

Gjithashtu, për gjykatën nuk mund të jetë i mjaftueshëm thjesht përfundimi se ekziston mospërputhje ndërmjet të ardhurave të personit të dyshuar dhe pasurive të fituara prej tij, për të çmuar se të gjitha pasuritë duhet të sekuestrohen dhe konfiskohen. Krahës kësaj, gjykata duhet të individualizojë, sipas rrethanave, në mënyrë të mjaftueshme për efekte vetëm të procedimit parandalues, edhe ekzistencën e një lidhjeje shkakësore të caktuar ndërmjet veprimtarisë kriminale të personit të dyshuar (sipas nenit 3 pika 1) dhe përfitimit të pajustificuar ligjërisht të pasurisë prej tij.

Pra, masat preventive pasurore sipas ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 gjejnë zbatim nëse mënyra e fitimit, prejardhja e pasurisë së personit të dyshuar apo personave të tjerë (neni 3), e cila zotërohet direkt a tërthorazi prej personit të dyshuar, nuk është e justifikuar ligjërisht, si dhe ka lidhje me pjesëmarrjen, kryerjen nga personi i dyshuar të një kategorie të caktuar veprash penale.

Në këtë kuptim, pavarësisht nga përmbajtja e nenit 3 pika 3 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, këto masa nuk mund të zbatohen nëse nga procedimi parandalues dhe gjykimi i kërkesës së prokurorit për vendosjen e tyre rezulton se pasuria është fituar (në mënyrë të justifikuar ligjërisht ose jo), është vendosur në çdo mënyrë në zotërim të personit të dyshuar përpara kryerjes së veprës penale që i atribuohet apo për të cilin ai është dënuar (neni 3 pika 1 e ligjit).

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka parashtruar si çështje për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore, edhe interpretimin e neneve 7 e 10 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, nëse sekuestrimi paraprak (neni 7) dhe sekuestrimi (neni 10) janë faza të domosdoshme të një procesi që duhet kryer për të arritur të konfiskimi, apo janë koncepte të shkëputura nga njëri-tjetri dhe si të tilla veprojnë pavarësisht njëri-tjetrit. Po kështu, nëse konfiskimi bëhet vetëm në rastet pasi më parë është vendosur pezullimi dhe sekuestro (neni 9 e 10), apo edhe në rastet kur më parë është vendosur vetëm sekuestro paraprake (neni 7).

Në çështjen objekt i këtij gjykimi, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me kërkesën dhe praninë vetëm të prokurorit, ka vendosur masën e sekuestros paraprake mbi pasuri të personit të dyshuar Xhevdet Tropolini, duke caktuar datën e seancës së shqyrtimit (vleftësimit) të saj në praninë edhe të personit të dyshuar. Në datën e caktuar, duke thirrur edhe personat e tjerë të lidhur me personin e dyshuar dhe pasuritë subjekt i masave pasurore, gjykata çmoi të vendosë masën e sekuestros mbi pasuritë pasi u dha në gjykim pjesëmarrësve në proces mundësinë të parashtronin provat e pretendimet e tyre, sipas detyrimeve dhe barrës përkatëse të provës.

Në zbatim të drejtë të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004, procedimi parandalues fillon me nismën e prokurorit, i cili kryen të gjitha veprimet e çmuara prej tij për të verifikuar ekzistencën ose jo të rrethanave dhe kushteve të lartpërmendura. Por, sipas këtij ligji, prokurori në asnjë rast nuk mund të vendosë masa mbi pasuritë që i nënshtrohen hetimit parandalues. Këto masa, me kërkesën e tij, vendosen vetëm nga gjykata.

Si pjesë e domosdoshme e procedimit parandalues, nëse ekzistojnë rrethana dhe kritere të verifikueshme “për të cilat parashikohet zbatimi i masës së konfiskimit” (neni 7, pika 1) si dhe ato të

nenit 13, me kërkesën e prokurorit, gjykata mund të vendosë si masë sigurimi pasuror **atë të sekuestrimit të pasurisë (neni 13).**

Por, duke mbajtur parasysh kriteret e mësipërme, me kërkesë të motivuar posaçërisht nga ana e prokurorit, gjykata mund të vendosë më parë edhe masën e **sekuestrimit paraprak** të pasurisë, për shkak se, deri në plotësimin e hetimeve mbi një pasuri konkrete, rrezikohet që ajo të humbasë, përvetësohet, tjetërsohet e të tjera rreziqe që lidhen me natyrën e një sekuestroje preventive (neni 7 pika 1) (neni 10).

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin se, në çdo procedim parandalues, sekuestrimi paraprak (neni 7 pika 1) dhe sekuestrimi (neni 10), (neni 13), nuk janë masa sigurimi pasuror të domosdoshme, në kuptimin që, edhe kronologjikisht, duhet t'i kërkohej e vendosen nga gjykata njëra pas tjetrës, përpara se prokurori t'i kërkojë gjykatës konfiskimin e pasurisë. Sekuestrimi paraprak, sipas këtij ligji, vendoset vetëm nëse ekzistojnë rrethanat të posaçme (neni 7 pika 1), masë e cila ka efekte të përkohshme deri në konfirmimin ose jo të saj në sekuestro, në seancën gjyqësore të caktuar për këtë qëllim nga gjykata që ka dhënë vendimin e sekuestros paraprake.

Nenet 7 dhe 10 të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 kanë të përbashkët, trajtojnë, çështje që lidhen me kriteret e procedura për vendosjen e masës së sekuestros. Por, nga ana tjetër, lidhur me natyrën e pasurisë, neni 7 gjen zbatim për çdo lloj pasurie, përveç atyre që lidhen me rrethanat, subjektet dhe masat e parashikuara në nenet 8 dhe 9 të ligjit, për të cilat zbatohet neni 10.

Masa e sekuestros sipas nenit 10, nëse çmohet e bazuar, zbatohet pasi të jetë vendosur më parë ajo e pezullimit të përkohshëm të administrimit të pasurisë (neni 9, pika 1). Nga ana tjetër, masa e sekuestros, sipas nenit 10, kur ekzistojnë rrethanat e treguara në nenin 7, pika 1, mund të paraprihet nga ajo e sekuestros paraprake.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se masa e konfiskimit të pasurisë jepet nga gjykata mbi kërkesën e motivuar të prokurorit, nëse përmbushen kriteret ligjore të treguara në nenet 24 deri 26 të ligjit, pasi të jetë vendosur më parë masa e sekuestrimit mbi pasurinë (neni 13), ndërsa në rastin e pasurive sipas nenit 8, pasi të jetë vendosur më parë masa e pezullimit të përkohshëm të administrimit dhe disponimit të pasurisë (neni 9 pika 1), apo nëse është urdhëruar më pas, eventualisht, edhe ajo e sekuestrimit të tyre (nenet 10, 13).

Sekuestro paraprake vendoset nga gjykata nëse janë të mbështetura në ligj motivet dhe rrethanat që përmban kërkesa e posaçme për këtë qëllim nga ana e prokurorit (neni 7 pika 1 në lidhje me nenet 13 e 26). Gjukata, brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës, mund të vendosë sekuestron paraprake, në një seancë gjyqësore, të zhvilluar vetëm me “praninë e prokurorit” (neni 7 pika 2), pra “përpara caktimit të datës së seancës gjyqësore” (neni 7 pika 1). Në këtë vendim, gjykata përcakton edhe datën e zhvillimit të seancës pasardhëse gjyqësore.

Ndonëse ligji nuk parashikon ndonjë afat konkret, nisur nga natyra dhe efektet e procedimit parandalues, parimet universale të gjykimit të pandërprerë, afatet e përgjithshme të vlefshmërisë së masave të sigurimit pasuror, si dhe emergjenca, përkohshmëria e motivet ku mbështetet vendosja e sekuestros paraprake, duke çmuar edhe rrethanat konkrete të çështjes dhe kohën objektive në dispozicion të palëve për pjesëmarrje në gjykim, gjykata duhet të caktojë datën e seancës gjyqësore dhe atyre eventualisht pasardhëse në një afat sa më të shkurtër. Në afatin e vlefshmërisë së masës së sekuestros (neni 13) llogaritet edhe periudha që ka kaluar nga dita e vendosjes së sekuestros paraprake (neni 7, pika 4 dhe 5, 9, 10, 13, 14).

Këto seanca gjyqësore mundësojnë që prokurori të parashtojë në mënyrë të detajuar motivet dhe provat që mbështetin kërkimet e tij, mbrojtjen e personit të dyshuar, thirrjen për të ndërhyrë në proces, edhe kryesisht, të personave të tretë që rezultojnë të jenë subjekt i masave të sigurimit pasuror, nëse kërkohet nga prokurori, kohën e nevojshme në dispozicion të tyre për përmbushjen e detyrimit për të justifikuar prejardhjen e ligjshme të pasurisë, si dhe veprime të tjera në funksion të zhvillimit të një procesi të rregull ligjor, në një afat sa më të shkurtër, për dhënien e një vendimi të mbështetur në ligj dhe në prova lidhur me vendosjen ose jo të masës së sekuestros (nenet 7, pika 1 dhe 3, 10, 13, 14 dhe 16).

Së fundi Kolegji Penal, në vendimin e tij ka parashtruar si çështje për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për efekt të unifikimit të praktikës gjyqësore edhe atë për interpretimin e masës "pezullim i

përkohshëm i administrimit dhe disponimit të pasurive" (neni 9) dhe lidhja e tij me sekuestrimin (neni 10), nëse janë hallka të një procesi që duhen zbatuar patjetër për të arritur te konfiskimi, apo mund të veprojnë pavarësisht nga njëra-tjetra.

Masat pasurore, sipas ligjit nr.9284, datë 30.09.2004, zbatohen, së pari: ndaj personave të dyshuar dhe personave të tjerë (neni 3, pika 1, dhe neni 3), së dyti: ndaj personave dhe veçanërisht subjekteve të tjera juridike që nuk përfshihen në nenin 3, por ndodhen në rrethana kërcënimi e ndikimi nga personat e dyshuar. Në rastin e dytë gjejnë zbatim të posaçëm edhe dispozitat e neneve 8 deri 13 të ligjit.

Në këtë kontekst, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, në rastin e personave juridikë, pavarësisht nga respektimi i formës në strukturimin dhe mënyrën e funksionimit, në procedimin parandalues synohet e duhet të provohet që organet drejtuese të tij, persona konkretë që ushtrojnë funksionet përkatëse në këto organe, janë në gjendje, në kushtet juridike e faktikë që të drejtojnë subjektin, pra dhe të veprojnë për llogari të personave të dyshuar, duke treguar kështu se ky subjekt kontrollohet, disponohet në fakt nga personi i dyshuar, shërben si një mjet, një bazë, për të lehtësuar dhe realizuar qëllimet dhe produktet e veprimtarisë së tij kriminale sipas nenit 3 pika 1 të ligjit.

Mbështetur në të dhënat e mjaftueshme që rezultojnë nga hetimet e kryera, prokurori i kërkon në mënyrë të motivuar gjykatës që, në gjykimin i cili zhvillohet ndaj personit të dyshuar, të thirren edhe ata persona që janë pronarë e zotërues të të drejtave pasurore të subjektit juridik, anëtarët e organeve drejtuese të tij etj., duke i detyruar që të justifikojnë ligjshmërinë e disponimeve pasurore dhe të veprimtarisë të tyre, si dhe të paraqesin prova se subjekti nuk është nën ndikimin dhe kërcënimin e personave të dyshuar (neni 8).

Në vijim, nëse rezultojnë të dhëna të mjaftueshme të kërcënimit, ndikimit, kontrollit mbi subjektin nga personi i dyshuar, prokurori mund t'i kërkojë gjykatës edhe vendosjen e masës së pezullimit të përkohshëm të administrimit dhe disponimit të veprimtarisë dhe pasurive të subjektit (neni 9, pika 1). Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata mund të vendosë konfiskimin e këtyre pasurive dhe veprimtarive.

Prandaj Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se, nëse në hetim dhe gjykim rezultojnë të dhëna të mjaftueshme dhe motive të tjera se ekzistojnë rreziqe reale për humbjen, përvetësimin, tjetërsimin etj. e pasurive dhe të drejtave të subjektit, prokurori mund të kërkojë edhe sekuestrimin e tyre (neni 10), pa përjashtuar edhe sekuestron paraprake (neni 7). Por masat e sekuestros nuk janë hallkë, masë e domosdoshme përpara se t'i paraqitet gjykatës kërkesa për konfiskimin e pasurisë dhe veprimtarive të personave dhe subjekteve të treguar në nenin 8 të ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 141, pika 2 të Kushtetutës, nenit 17 shkronja "a" të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë" dhe të nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSËN:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr.37, datë 10.7.2006 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda.
2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.
3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njëson praktikën gjyqësore.

Kryesues: Thimjo Kondi

Anëtarë: S. Spiro, P.Zaharia, I.Bala, Sh.Beçaj, A.Dvorani, F.Lulo

MENDIM I GJYQTARËVE NË PAKICË

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton që ndaj shtetasit Xhevdet Troplini, mbi bazën e një bashkëpunimi me autoritetet italiane, në datën 2.11.2005 ka filluar çështja penale regjistruar me nr.88,

me të cilin Xhevdet Troplini është marrë i pandehur dhe është arrestuar për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i tretë i Kodit Penal. Gjatë vazhdimit të hetimit për veprimtarinë kriminale të të pandehurit, pasi prokuroria e krimeve të rënda ka evidentuar se i pandehuri kishte pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe duke vlerësuar se ajo rridhte nga veprimtaria e tij kriminale, i ka kërkuar Gjykatës së Krimeve të Rënda në datën 7.4.2006 sekuestrimin e kësaj pasurie dhe me vendimin nr.39 akti, datë 10.4.2006, Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur të sekuestrojë pasurinë e të pandehurit Xhevdet Troplini.

Si prokuroria, ashtu edhe Gjykata e Krimeve të Rënda, kan mbështetur respektivisht kërkesën dhe vendimin në ligjin nr.9284, datë 30.9.2004, nenet 3, 7, 13 të tij. Këtë vendim e kanë ankimuar si i pandehuri, ashtu edhe familjarët e tij, kërkuarit Shefqet Troplini, Lule Troplini dhe Majlinda Troplini, duke pretenduar se pasuria nuk rrjedh nga krimi dhe se ajo pasuri nuk është vetëm e të pandehurit, por edhe e familjarëve të tij. Vendimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda dhe po ashtu u la në fuqi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjyqtarët në pakicë nuk janë dakord me të gjitha këto vendime, për shkakun se të tria gjykatat kanë aplikuar gabim ligjin e për rrjedhojë edhe përfundimet e tyre janë të kundërligjshme. Ligji, mbi të cilin janë bazuar për të arritur në përfundimin se pasuria e të pandehurit duhet sekuestruar, është ligji nr.9284, datë 30.9.2004, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar". Sipas këtij ligji, personave të dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe personave të lidhur me ta, mund t'iu sekuestrohet e më pas konfiskohet pasuria që lidhet me këto krime.

Kemi mendimin se ligji në fjalë nuk është i aplikueshëm për rastet kur ndaj personit që dyshohet për pjesëmarrje në krim të organizuar ka filluar çështja penale. Mendojmë se ky ligj ka efekte për të gjitha rastet e tjera që nuk lidhen me procedimin penal. Në momentin e marrjes së personit me cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim apo personit të cilit i atribuohet vepra penale, të cilët sipas nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale barazohen në pozitë procedurale, i bën ata subjekte të procedimit penal sipas kreut IV të Kodit të Procedurës Penale, seksioni i II-të i titullit I-rë, e për pasojë, ndaj tyre aplikohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kodi parashikon për të pandehurin. Të gjitha rregullimet e tjera që kodi ka në raport me pozita të caktuara procedurale të të pandehurit, gjatë gjithë fazave të procedimit të tij, janë të parashikuara në vetë përmbajtjen e kodit dhe në dispozita të posaçme të tij. Ndërkohë që një nga parimet themelore mbi të cilin ngrihet procedimi penal përcaktohet në nenin 1 të kodit, i cili ka sanksionuar se *"Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojë liritë personale, të drejtat dhe interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit"*.

Brenda këtij parimi, kodi ka bërë rregullime të tija për të garantuar një proces të barabartë për të gjitha subjektet që i nënshtrohen atij, duke përcaktuar kufizime të cilat lidhen kryesisht me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve me drejtësinë, në mënyrë të veçantë në raport me të akuzuarit për vepra penale që lidhen me trafiket dhe krimin e organizuar. Gjithsesi, në të gjitha rastet e rregullimeve të posaçme ato janë të parashikuara brenda këtij korpusi normash që përbëjnë Kodin e Procedurës Penale që, sipas Kushtetutës, është një ligj që miratohet me votë të cilësuar dhe që në hierarkinë e normave vjen pas Kushtetutës së Shqipërisë, neni 81 i saj.

Në këto kushte, kemi mendimin se në këtë çështje, derisa për të pandehurin e arrestuar ka filluar një procedim penal, çdo kërkesë dhe vendimmarrje për lirinë dhe të drejtat e tij, përfshi dhe ato pasurore, duhet të mbështetet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 208 e në vazhdim i këtij kodi dhe dispozita të tjera të tij nuk parashikojnë rregullime të posaçme për kategori të caktuara të personave të akuzuar për vepra të ndryshme penale, por kanë përcaktuar rregullat se si veprohet si përse i përket sekuestrimit dhe më pas, konfiskimit, kur rezultojnë kushtet që parashikon ligji ndaj pasurisë që rrjedh apo lidhet me një krim.

Edhe pse çështja penale kishte 6 muaj që kishte filluar për të pandehurin Xhevdet Troplini dhe ndaj tij po zbatoheshin normat e Kodit të Procedurës Penale, sekuestrimi i pasurisë së të pandehurit në kundërshtim me këto norma është kërkuar të bëhet me një ligj të posaçëm dhe jo brenda korpusit të dispozitave të cilat udhëheqin dhe mbi të cilat bazohet procedimi penal. Kjo mënyrë e të vepruarit, të pranuar edhe nga gjykatat, padrejtësisht dhe në mënyrë të kundërligjshme e ka vënë të pandehurin në pozitë të pabarabartë dhe në mënyrë të diskriminuar në raport me pozitën e tij procedurale dhe të drejtave që burojnë për personin e pandehur.

Ky qëndrim shkel parimin themelor mbi të cilin ngrihet procedimi penal, të sanksionuar në

nenin 1 të Kodit të Procedurës Penale. Lënia në vlerësim të organit të akuzës që në rastet analoge, për të cilat ka filluar një çështje penale, të kërkojë sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit apo personit nën hetim që të aplikojë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale apo dispozitat e ligjit nr.9284, date 30.09.2004, mendojmë se është shumë e rrezikshme dhe i hap rrugën një subjektivizmi me pasojë të drejtpërdrejte diskriminimi dhe vendosjeje në pozita të pabarabarta të subjekteve të njëjta procedurale, duke shkelur parimin themelor të ndjekjes penale dhe të drejtat dhe liritë procedurale e kushtetuese, për personat që dyshohen të kenë kryer vepra penale.

Ligji për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar i vitit 2004, sipas mendimit të gjyqtarëve në pakicë, duhet të interpretohet si një ligj që aplikohet për personat e dyshuar si pjesëmarrës në krimin e organizuar, ku futen jo vetëm drejtpërdrejt ata që janë pjesëmarrës në këto organizata kriminale, por edhe të tjerë, që edhe pse nuk janë drejtpërdrejt pjesëmarrës, kanë lidhje të afërta me ta, sikurse janë bashkëshorti, fëmijët, personat gjini e krushqi të afërt, por edhe personat fizikë e juridike pasuritë e të cilëve zotërohen drejtpërdrejt, pjesërisht ose plotësisht nga personat që dyshohen të kenë kryer krim të kësaj natyre.

Sikurse lehtësisht konstatohet në nenin 3 të ligjit, të titulluar “*rrethi i personave të dyshuar*”, sekuestrimi i pasurisë shtrihet edhe ndaj personave dhe subjekteve të cilët nuk kanë kryer vepra që lidhen me krimin e organizuar, duke treguar kështu se aplikimi i këtij ligji nuk lidhet me vetë procedimin penal, por është jashtë tij. Këtë qëndrim me të drejtën mbajnë edhe Kolegjet e Bashkuara në unifikim të praktikës gjyqësore, duke e konsideruar procedim parandalues dhe autonom me procedimin penal dhe atë civil.

Ky ligj, duke qenë me karakter të fortë represiv dhe që është bazuar në nevojën për të parandaluar dhe luftuar më mirë krimin e organizuar, ka efekte të kufizuara në kohë duke përcaktuar afate më të shkurtra sesa ato të Kodit të Procedurës Penale për kohën e vënies së sekuestros mbi pasurinë, por nga ana tjetër, ka lehtësuar mundësinë e vënies së saj në raport me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Mendojmë se ky është edhe shkak që ligjvënësi ka kufizuar kohën gjatë të cilës pasuria mbahet në sekuestro. Që ky ligj nuk lidhet me rastet kur ka një procedim penal, e tregon qartë, ndryshe nga sa pranon shumica, neni 27 i tij, ku në paragrafin e parë përcaktohet se masa e sekuestrimit ose e konfiskimit mund të vendoset edhe ndaj pasurive të sekuestruara në një procedim penal. Akontrario, duhet kuptuar se në një procedim penal aplikohen dispozita të tjera, Kodi i Procedurës Penale dhe vetëm në një rast ky ligj bën lidhjen me procedimin penal kur i jep të drejtë gjykatës që të vendosë sekuestro apo të konfiskojë pasuri mbi të cilat ajo ka disponuar më parë në procedimin penal, duke bërë kështu të mundur zbatimin e normave të këtij ligji të lidhura me ato të Kodit të Procedurës Penale. Sipas mendimit të pakicës, ky është i vetmi rast kur këto dy ligje mund aplikohen së bashku në një procedim penal. Pra në thelb ai është një ligj parandalues, ashtu sikurse ka edhe titullin dhe nuk është një ligj që shtrihet gjatë procedimit penal.

Pakica ka mendimin se në eventualitetin që Kodi i Procedurës Penale dhe ligji nr.9284, datë 30.9.2004, aplikohen së bashku, sikurse praktikisht kanë vendosur dhe unifikuar praktikën gjyqësore edhe Kolegjet e Bashkuara, duke qenë se dispozitat e këtij ligji rëndojnë dukshëm pozitën e të pandehurit që dyshohet të jetë pjesëmarrës në një krim të organizuar, duhet vlerësuar paraprakisht kushtetueshmëria e ligjit dhe çështja i duhej referuar Gjykatës Kushtetuese.

Nga ana tjetër, pakica ka mendimin se edhe sikur të pranohet që të dy këto janë ligje të aplikueshme, por që në thelb kanë rregullime me diferenca të mëdha në raport me liritë dhe të drejtat e të pandehurit, ligji i aplikueshëm jo vetëm për shkak të rëndësisë së tij sipas hierarkisë që përcakton neni 81 i Kushtetutës, por edhe për shkak të aplikimit të ligjit favorizues, bën që Kodi i Procedurës Penale të jetë ligji i zbatueshëm.

Ligji shqiptar nuk është një ligj origjinal. Për hartimin e tij ka shërbyer ligji italian, por situata ligjore dhe kushtetuese mes dy vendeve është e ndryshme. Italia, për të gjitha kodet e saj parashikon që të shoqërohen me ligje aplikues, të cilat shpjegojnë dhe zhvillojnë me tej dispozita edhe institute të kodeve, duke i plotësuar ato në aspekte të caktuara, duke i bërë normat e ligjit të barasvlershme me ato të kodeve. Në këto kushte, ligjet komplementare lejohen të vënë rregulla të reja ose të detajuara në raport me kodet, por pa u konsideruar ato kontradiktore me kodin për shkak të diferencës së hierarkisë së normës juridike.

Në sistemin ligjor shqiptar, një gjë e tillë nuk lejohet nga Kushtetuta. Në qoftë se ligjvënësi do të donte të ndryshonte standardet e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë që rrjedh nga një krim, për disa vepra penale të rënda, siç është rrethi i atyre që rregullon ligji në shqyrtim, ato duhet të bëheshin

në vetë Kodin e Procedurës Penale dhe jo me një ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë në Kuvend. Në të kundërt, nuk mund të ndryshohen apo të vihen norma represive në raport me ato të kodit, me një ligj të posaçëm. Nëse kjo ndodh, prevalon zbatimi i normave të Kodit të Procedurës Penale, si ligj më i lartë në hierarki.

Në këto kushte, pakica ka mendimin se: **Në rastet kur është aplikuar ligji nr.9284, datë 30.9.2004, dhe më pas fillon procedimi penal ndaj personave të akuzuar apo dyshuar për veprat penale për të cilat zbatohet ky ligj, pas këtij momenti, të gjitha veprimet lidhur me sekuestrimin, konfiskimin e pronës dhe të drejtat e personit nën hetim, duhet të mbështeten në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.**

Bazuar mbi këtë afirmim, duke konstatuar se si kërkimi, ashtu edhe vendimmarrja për sekuestrimin e pasurisë së të pandehurit Xhevdet Troplini është bazuar në zbatim të gabuar të ligjit, kemi mendimin se të dy vendimet gjyqësore duhej të ishin prishur e për pasojë masa e sekuestros mbi pasurinë duhej hequr. Organi i akuzës, në çdo kohë, bazuar në prova se pasuria është e lidhur me veprat penale për të cilat i pandehuri Xhevdet Troplini akuzohet, mund të kërkojë vënien e masave të sekuestros mbi to, duke i dhënë atij mundësi, por edhe të tretëve që preken në interesat e tyre pasurore, për të kundërshtuar dhe kërkuar verifikimin e vendimeve në gjykatat më të larta.

Anëtarë: A. Hoxha, G. Dizdari, K. Ngjela, B. Imeraj, A.A Lamaj, E. Sinojmeri